*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F502RED dhe F579*

E mërkurë, 3 maj 2023

[Seancë e hapur]

[I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes. Mirë se keni ardhur.

Z. Sekretar, ju lutem a mund të thërrisni çështjen.

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Është çështja numër KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Palët dhe pjesëmarrësit, njoftoni kush është i pranishëm.

Prokuror, keni fjalën.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Line Pedersen, Eva Wyler, Gaia Pergolo.

Z. LAWS: [Përkthim] Simon Laws, Mbrojtësi i Viktimave, në këtë rast bashkë me bashkëndihmësen time, Maria Radziejowska.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtës, keni fjalën.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi këtu në emër të z. Pjetër Shala, që është në qendrën e ndalimit. Dhe këtu kemi Hedi Aouini, bashkëavokat, znj. Petravica, përgjegjëse e çështjes, Judit Kolbe, Francisca De Castro dhe Xhulia Tepshi. Ky është ekipi ynë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

Z. Shala, a mund të më konfirmoni se më dëgjoni mirë?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj. Mirëmëngjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala.

Sot do të vazhdojmë me pyetjet kryesore nga Zyra e Prokurorisë dhe pastaj do të bëjë pyetje Mbrojtësi i Viktimave dhe pyetjet pastaj pala Mbrojtëse. Ky është programi për ditën e sotme.

Do të ndjekim të njëjtën program sikundër dhe dje dhe pardje, zakonisht me seanca një orë e gjysëm dhe pushime nga 30 minuta dhe një orë e gjysëm për drekën.

Sikundër dje dëshmitari do deponojë përmes videolidhjes.

Ka diçka që duhet ta them. Kemi disa referenca për procesverbal lidhur me transkriptin në shqip të intervistës që ka dhënë dëshmitari me Prokurorinë në 2022. Fragmentet janë përdorur nga Trupi Gjykues dje dhe do t'i përdorim ende ato referenca. Dhe ato kanë qenë ato referencat e përdorura në pyetjet që u bënë dëshmitarit dje.

Unë do t'i lexoj me ngadalë që t'i përkthejnë përkthyesit dhe t'i shkruajë stenografia, bëhet fjalë për faqen 15, rreshtat 3 deri në 5 të transkriptit me numër ERN 108836-TR-ET dhe është Pjesa 1, që i korrespondon faqes 17, rreshtave 15

deri në 17 të transkriptit me numër ERN 108836-TR-AT, Pjesa 1 dhe referenca Pjesa 2 është faqja 17, rreshtat 16 deri në 18 të transkriptit me numër ERN 108836-TR-ET, Pjesa 1, që i korrespondon faqes 20, rreshtave 8 deri në 11 të transkriptit me numër ERN 108836-TR-AT, Pjesa 1.

Gjithashtu kam dy gjëra që dua t'i them lidhur me materialet që do të përdorin palët dhe Mbrojtësi i Viktimave gjatë pyetjeve të tyre. Pikë së pari, për t'i thjeshtuar procedurat. Propozimi është që palët dhe Mbrojtësi i Viktimave së pari të kërkojnë lejen e Trupit Gjykues kur duan të paraqesin një prove materiale, duke vënë në dukje se përse dëshirojnë që ta përdorin atë material. Në qoftë se kjo mund të bëhet në seancë publike apo private, në varësi të asaj duan t'i tregojnë Panelit për të kuptuar arsyetimin. Nëse jepet miratim, mund të jepni numrin e provës materiale dhe pastaj ajo provë do të paraqitet në ekran. Në qoftë se ndjekim kë të procedurë, shpresoj që nuk do të kemi folës që të mbivendosen, siç vura re dje ndonjëherë. Thjesht për ta thjeshtuar.

Në rregull. Dhe pika e dytë që dua të ngre është që, sikurse, në fakt, e vumë re disa herë, tregojini Trupit Gjykues  se kur mund të hiqen ato dok nga ekrani.

Në rregull. Sekretare në dhomën ku do të vijë dëshmitari, a mundet që ta sillnin dëshmitarin dhe gjithashtu dëshmitari, sikundër të gjithë palët, të prezantohet.

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] I pranishëm në dhomën këtu jam unë dhe Dëshmitari 11.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, mirëmëngjes. Më dëgjoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Po, ju ndëgjoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se keni ardhur përsëri.

Z. Shala, e ndëgjoni dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj mirë. Ju faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, si jeni sot?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Mirë. Falemnders.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot do të vijojmë me pyetjet që do t'ju bëj Prokurori i Specializuar. Dua t'ju kujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën. A e keni të qartë këtë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Z. Prokuror, keni fjalën.

DËSHMITARI: TW4-11

[Dëshmitari dëshmon përmes videolidhjes]

Pyetje nga Z. De Minicis:

Z. De MINICIS: [Përkthim]

PY. Mirëmëgjes, z. Dëshmitar. Mirë se erdhët përsëri.

Nuk kam dhe shumë pyetje të tjera, duam të vazhdojmë kështu. Së pari kam tre pyetje që dua t'jua bëj në vazhdim të atyre që diskutuam dje. Pastaj kam dhe dy tema të reja përpara se të përfundoj pyetjet e mia.

Pyetja e parë që kam për ju është: Dje na thatë se ishte Xhemshit Krasniqi ai që ju mori nga fabrika e metalit. Ai gjithashtu ju tha që, në dhomë, ju tha emrin dhe këtë e keni thënë faqen 50 të transkriptit të djeshëm.

Me sa kuptoj unë kur ai ju solli aty e keni parë të paktën njëherë kur ju tha emrin. E keni parë gjithashtu dhe në raste të tjera.

PË. Jo.

PY. Faleminderit. Dje na thatë gjithashtu se kishit një dyshek mbi të cilin flinin.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është faqja 80 deri në 81 në transkriptin e djeshëm.

PY. Gjithmonë keni pasur dyshek për të fjetur gjatë kohës që keni qenë në atë dhomë, gjatë atij muaji, a diçka e tillë?

PË. Jo, nuk kemi pasë tanë kohën.

PY. Faleminderit.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të kalojmë në seancë private sepse do t'jua shpjegoj. Por duhet

të diskutojmë lidhur me personat e mbrojtur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretar, të kalojmë ju lutem në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F579*

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit për kohën.

PY. Z. Dëshmitar, ju faleminderit. E dimë që nuk është e lehtë që t'ju kujtojmë të rikujtoni, herë pas here, diçka që ka qenë e dhimbshme për ju. Unë mbarova me këtë temë. Por kam edhe një temë tjetër që dua të mbuloj, përpara se ta bëj këtë dua të sqaroj.

Ju na thatë këtë historinë. Na treguat që një burrë ka vdekur në dhomën ku ishit ju dhe që një burrë tjetër u plagos. Keni dëgjuar krisma jashtë dhomës. Si u ndjeve në ato momente kur ndodhnin të gjitha këto në atë kohë e në atë dhomë?

PË. Po normal që nuk kam qenë i sigurtë. Dhe nuk kam qenë i qetë. Kam qenë në stres tuj mendue çka mund më ndodhë.

PY. A kishit frikë për jetën tuaj?

PË. Po, normal, që kisha frikë.

PY. Faleminderit. Në dëshminë tuaj na treguat me hollësi për kohën kur ju çuan në fabrikën e metalit në Kukës, kohën që u mbajtën të ndaluar, trajtimin, personat me të cilët ishit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më falni, që ju ndërpres. Të verifikoj, dua thjesht të sqaroj nëse do vazhdojmë në seancë private apo mund të kalojmë në seancë publike?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mund të kalojmë në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretar, të kalojmë në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Vazhdoni, z. Prokuror, ju lutem.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, andaj duhet të jemi të kujdesshëm të mos themi emrin dhe të dhëna të tjera identifikuese. Edhe unë do bëj kujdes.

PY. Ju i thatë Trupit Gjykues historinë e ndalimit tuaj në atë vend. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues si u liruat, si

ndodhi lirimi juaj?
PË. Po. Lirimi im ndodhi kur hyni NATO-ja në Kosovë dhe u çelën dyrët dhe vetëm kam dalë pi aty.
PY. Gjatë kohës që u mbajte i ndaluar, përpara se të liroheshit, a ju mori njeri në pyetje? Nuk e mbaj mend faqen, por mbaj mend që na ke thënë që njëherë gjatë ditës ju bënë disa pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E keni parasysh transkriptin e përkohshëm?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për procesverbal mund ta them, po thuaji kolegëve ta verifikoni është faqja 12, 22. Në qoftë se keni parasysh këtë faqe.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do ta verifikojmë.

PY. Pra, ju mori njeri në pyetje gjatë ndalimit tuaj, z. Dëshmitar?
PË. Po.
PY. Kush ju mori në pyetje? A e dini se kush ishte ky person e njihni identitetin e tij? Mund ta thoni emrin.
PË. Në atë moment, as nuk e dija, as nuk e kam pasë njoftë. Mbas çlirimit jam kthyer në Kosovë e kam kuptue që ka qenë Eqerem Kryeziu.

Më falni. Më falni. Gabim. Osman Kryeziu.

PY. Faleminderit. Trupit Gjykues i thatë që e mësuat kush ishte emrin e tij mbas lufte. Atë ditë që u mori në pyetje, a

u prezantua ai se kush ishte?

PË. Më tha që jam gjykatës apo prokuror. Nuk e di, s'e mbaj mend çka më tha. E më tha "Duhet me t'i bë disa pyetje".

PY. A ju tha se cilën organizatë përfaqësonte, për cilin punonte si prokuror apo gjykatës, ja u tha këtë gjë?

PË. Jo.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që t'i tregoj dëshmitarit një hollësi tjetër që ia dha Prokurorisë gjatë intervistës. Të lutem të shohim provën materiale 059351-TR-ET, Pjesa 2.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është faqja 12 në anglisht dhe 14 në shqip. Në të dyja është faqja 12 dhe në anglisht dhe në shqip - më falni.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Në kohën që i keni dhënë intervistë Prokurorisë, nuk po e nxjerrim datën, kemi diskutuar për këtë intervistën tuaj dhe ju keni thënë:

"E që kur më mbajtën për një muaj më morën në pyetje më çuan tek një person që ishte prokuror dhe ai më tha 'Jam prokuror i UÇK-së'. Këta ma tha. Më mori rreth gjysëm ore në pyetje dhe që nga ajo kohë nuk e kam parë më".

Pyetja e parë që kam për ju është: Nga kjo që keni thënë

aso kohe prokurorit, ky burri ju ka thënë ka qenë prokuror i UÇK-së. A e mbani mend?
PË. Nuk më kujtohet, të vërtetën me jua thënë. Ka mundësi edhe që më ka thënë.
PY. Faleminderit. E vlerësoj përpjekjen tuaj.
Vërej një gjë këtu, ju thatë që personin e takuat pas lufte dhe ai u tregoi kush ishte por këtu keni thënë, në këtë deklaratë, që s'e keni parë ndonjëherë më, që nga ajo kohë që u mori në pyetje.
A keni parë personin përsëri mbas lufte, këtë personin që u mori në pyetje?
PË. Një herë e kam pa.
PY. Faleminderit. Në fund të periudhës që u mbajtën të ndaluar dhe --
Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund ta heqim dokumentin nga ekrani.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.
Z. DE MINICIS: [Përkthim]
PY. Në fund të ndalimit që u mbajtën aty, a e kuptuat ndonjëherë se kush ju kishte mbajtur të ndaluar, cili grup ishte përgjegjës për ndalimin tuaj?
PË. Jo, nuk e kam kuptue.
Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund ta vendosim përsëri transkriptin në ekran?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po. Vazhdoni, Sekretar.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është në fund të faqes 12 dhe në fund të faqes 13 në anglisht. Besoj dhe në shqip duhet të jetë e njëjta.

*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Prokuror, një minutë sa të paraqiten në ekran të dy versionet në anglisht dhe në shqip.

Faleminderit, z. Dëshmitar, për durimin që po tregoni.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Po ju bëj këtë pyetje sepse ju ka pyetur atëherë prokurori:

"Është e saktë të themi se ju e kuptuat që po ju mbante të ndaluar UÇK-ja?"

Dhe është në faqen 13, rreshtat 1, 3:

"Po, është e vërtetë. E kuptova që Xhemshit Krasniqi ishte pjesë e UÇK-së, por kur erdhi të më arrestonte ishte i veshur civil".

Pra, z. Dëshmitar, po ju pyes, nga intervista më duket se e keni kuptuar atëhere se kush ishte personi, kujt i përkiste personi që u ka arrestu apo jo?

A doni t'jua përsëris pyetjen, z. Dëshmitar?

PË. Po, s'e nuk e pata të qartë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Përdorët fjalën "për t'u arrestuar", "që ju ka arrestu".

Nuk e di nëse mund të quhet arrestim.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ishte përpara se të lirohej.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E ngre këtë çështje sepse atë e sollën nga një vend në një vend tjetër.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në rregull.

PY. Pra, prokurori ju ka pyet:

"Është e saktë të themi se ju e kuptuat që ju kish mbajt të ndaluar UÇK-ja?"

Dhe ju thatë:

"Po. Këtë e kuptova se Xhemshit Krasniqi ishte pjesë e UÇK-së, por kur më ka arrestu ka qenë civil".

Sepse më herët ju pyeta, a e kuptuat se kush ju ka arrestu, çfarë përfaqësonte ai dhe ti the "jo". Por nga kjo pyetje këtu dhe nga përgjigja që i ke dhënë prokurorit duket se e ke kuptu se personi që të ka arrestu, me fjalët që ke thënë, që erdhi për t'ju arrestu, ka qenë në UÇK.

A ju kujtohet kjo? Është e saktë?

PË. Po, e saktë.

PY. Faleminderit. Tani, a ju kujtohet se çfarë pyetje ju ka bërë ky prokuror apo gjykatës gjatë marrjes në pyetje, përpara se të liroheshit?

PË. Po më ka bë pyetje "Shka ke punu? E ku ke qenë në kohë të ofensivës, të luftës?" Dhe qesi pyetje.

PY. A ju dha ndonjë shpjegim për arsyen përse ju kishin mbajte të ndalum për mbi një muaj?
PË. Jo. Më tha vetëm më vjen keq se nuk kam kurrnifarë argumenti ndaj teje kështu që.
PY. Gjatë ndalimit tuaj, a jua shpjegoj njeri tjetër sepse jua kishin marrë lirinë, pse ju kishin privu nga lira gjatë asaj kohe?
PË. Jo, kush nuk më ka tregu asgjë për çfarë arsye.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më herët më kërkuat referencë lidhur me marrjen në pyetje, në transkript do të ishte faqja 1222, rreshtat 19 deri në 20.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem të paraqisni në ekran atë identifikimin e fotografive që ka bërë dëshmitari *[REDAKTUAR]* që ka të bëjë me personin -- që ka të bëjë me këtë personin në kuadër të pyetjeve, marrjes në pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Pra, tregoni dokumentin 00013100 deri në 00013122 RED3, faqja 20, ju lutem.

PY. Z. Dëshmitar, e shikoni në ekran këtë dokumentin?
PË. Po.

PY. A shikoni një nënshkrim tek fotografia numër 74?
PË. Po.
PY. A njeh këtë nënshkrim?
PË. Po.
PY. I kujt është ky nënshkrim?
PË. Ky nënshkrim është i imi.
PY. A e njihni personin që ka dalë në fotografinë 74?
PË. Po.
PY. A mund t'i thoni Gjykatës se kush është ky person?
PË. Ky është Osman Kryeziu.
PY. Pra, ju kuptoj drejt që ky është personi që u prezantua si prokuror dhe që u bëri pyetje para lirimit, kështu është?
PË. Po.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mbarova punë me këtë dokument.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. E dëgjova dëshmitarin të thotë që prokurorin apo gjykatësin nuk e mbante mend.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]
PY. Z. Dëshmitar, po thuaj se i kam mbaruar pyetjet. Kam dhe nja dy të tjera.
E para është: Këto që na tregove sot, ndalimi aty, rrahjet, kur ke parë ato që ke parë, frikën që ndjerë, si i ke përjetu të gjitha këto si njeri?
PË. Po si njeri, që normal i kam përjetue rëndë. Jo bash lehtë.

PY. Fakti që u ndave nga familja, familja ishte në kamp refugjatësh, e gjithë kjo si të bëri të ndihesh në kohën që ishe larg tyre, gjatë atyre kohëve të vështira?

PË. Po, normal, nuk kam ndje mirë. Ndaj kam qenë në kujtime, në mendime çka ndodhi, pse ndodhi e qësi raste, kësi gjena. Mezi pritja me u taku me familjen.

PY. A ishit i shqetësuar për familjen për mundësinë që kishte ajo për të siguruar jetesën në mungesën tende?

PË. Po, isha i qetësuat. Kam pasë babën moshatar diku afër 80 vite. Kështu që, pak a shumë, nuk kanë mujt me u gjetë. Kështu që mendjen e kisha edhe te ata ma tepër.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mundet që të konsultohem pak me kolegët para se të vazhdoj?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, ju falënderoj shumë për përpjekjet që keni bërë për të kujtuar edhe njëherë këto ngjarje të dhimbshme. Nuk kam më pyetje për ju.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

Z. Dëshmitar, faleminderit. Së pari do të bëjmë një pushim dhe pastaj do të vazhdojmë.

Mbrojtësi i Viktimave, do të kini pyetje pas pushimit.

Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje për këtë dëshmitar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim dhe do të vazhdojmë në orën 11.30. Do t'i them Sekretares që t'ju shoqërojë të dilni nga dhoma. Dhe do të shihemi mbas pak. Faleminderit shumë.

[Dëshmitari përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Dëshmitari ka dalë nga dhoma.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare.

Përpara sesa ta ndërpresim punën, ka gjë që do të ngrejë Prokuroria ndonjë çështje?

Ju si Mbrojtësi i Viktimave?

Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe ju si Mbrojtje?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo. Faleminderit, e nderuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] atëherë mbas pushimit do të vijojmë me pyetjet e palës suaj.

Dhe shihemi përsëri në orën 11.30. Këtu e ndërpresim.

--- Pauza fillon në orën 10.53

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u kthyet. Të shohim nëse ka ndryshim nga ekipet. Në të majtën.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk ka ndryshime.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] As Mbrojtësi i Viktimave dhe as në ekipin e Mbrojtjes nuk ka ndryshime.

Shohim që z. Shala është i pranishëm.

Shumë mirë. Do i lutesha Sekretares që të sjellë sërish Dëshmitarin.

[Dëshmitari fillon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, a më dëgjon?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Mirë se u kthyet!

Mbrojtësi i Viktimave na bëri me dije se nuk ka pyetje. Tani do fillojmë me ekipin e Mbrojtjes.

Avokati Mbrojtës keni fjalën për pyetjet tuaja.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

Që të sigurohemi që edhe z. Shala e dëgjon Dëshmitarin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala, a e dëgjon Dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ishte një “Po” bindëse.

Faleminderit. Z. Avokat, fjala është për ju.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjesi, z. Dëshmitar.

Pyetje të palës tjetër nga z. Gilissen:

Z. GILLISEN: [Përkthim]

PY. Unë jam z. Gilissen. Jam Avokati Mbrojtës i z. Shala. Kam veshur mantelin e kuq edhe dëshiroj t'ju bëj disa pyetje që të sigurohemi që i kemi kuptuar të gjitha siç duhet apo për të marrë ndonjë hollësi tjetër lidhur me dëshminë tuaj që keni dhënë sot. Faleminderit që jeni këtu me ne.

Dhe pyetja e parë që dëshiroj t'ju bëj është: në vitin 1999, a njihnit ndonjë që quhej Pjetër Shala kur ishit në fabrikën e metalit në Kukës?

PË. Jo.

PY. Faleminderit, shumë e qartë. Sot në transkript, në transkriptin e ditës së sotme, faqja 27, rreshtat 18 dhe 24, keni përmendur z. Xhemshit Krasniqi edhe bëtë lidhjen, nëse e kam kuptuar siç duhet, sepse ky është edhe qëllimi i pyetjes sime, a bëtë një lidhje mes z. Krasniqi dhe arrestimit tuaj dhe ndalimit tuaj. Pra, a lidhni z. Krasniqi me ndalimin dhe arrestimin tuaj?

PË. Më fal, s'e kuptova mirë pyetjen.

PY. Po, do përpiqem ta përsëris në mënyrë tjetër, ta riformuloj.

A bëni lidhje ju për ndalimin dhe arrestimin tuaj me z. Xhemshit Krasniqi? Pra, a e lidhni z. Xhemshit Krasniqi me ndalimin dhe me arrestimin tuaj?

PË. Po.

PY. Në të shkuarën, përpara ’99, e njihnit z. Krasniqi?
PË. Jo.
PY. Dhe para ’99, a njihnit ndokënd nga familja e Xhemshit Krasniqit?
PË. Jo.
PY. Më duhet t’ju pyes, a jeni tifoz futbolli?
PË. Po.
PY. *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, mos duhet të kalojmë në seancë private?

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F502RED dhe F579*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Avokati i Mbrojtjes, keni fjalën.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Lidhur me këto dyshekë dhe batanijet, sot në faqen 81 të transkriptit, rreshti 1 deri në 2, na thatë këto dyshekët dhe batanijet u zhdukën, a mund të na shpjegoni se çka ndodhur në lidhje me këto?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një minutë, një minutë.

Nuk e mbaj mend që është përdor fjalë "janë zhdukur". Nuk e kam kuptuar kështu. Në faqen 81 thatë? Nuk mundet të jetë 81 se jemi në faqen 51 tani.

Z. GILISSEN: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar] Faqja 5, rreshti 18 deri në 20 dhe është transkripti i sotëm ky. Por unë citova të djeshmin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot, është fjala për sot? Faqja... sot.

Pyetja është, "Keni pasur gjithmonë një dyshek për të

fjetur". "Jo gjatë gjithë kohë", përgjigja. Faleminderit.

Nuk shoh këtu që të përdoret fjala, "zhdukje, janë zhdukur". Mbase nuk kanë qenë aty dhe ju janë dhënë. Pra, do ta bëja pyetjen në një mënyrë tjetër, ju lutem.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Patjetër.

PY. Z. Dëshmitar, gjatë kohës që keni qenë i ndaluar, a keni pas batanije dhe dyshekë dhe/ose dyshekë në dispozicion?

PË. Po, kemi pasë, por vetëm një periudhë njëditore na janë hjek prej dhomës

PY. Po. Dhe atë që unë e quaj, u zhdukën batanijet dhe dyshekët, a keni diskutuar këtë çështje me z. Xhemshit Krasniqi, pra, fakti që janë zhdukur ato dyshekët dhe batanijet?

PË. Unë nuk e kam pasë njoftur Xhemshit Krasniqin, por në një moment kur ka ardhë te dera dhe na ka pa në beton çka kemi qenë, pa batanije dhe pa dyshekë na pyeti prej kur nuk keni dyshekë, i tregun na që për një ditë, q'aty tregoj, tha, unë jam Xhemshit Krasniqi, q'aty e kuptova dhe ndërkohë [e pakuptueshme] na ka pru batanijet dhe dyshekët prapë në dhomë.

PY. Pra, ju kuptova drejt? Pra, z. Krasniqi dukej se nuk kishte dijeni për zhdukjen e batanije apo jo?

PË. Jo, nuk ishte në dijeni.

PY. Faleminderit shumë. E njëjta gjë ndodhi dhe me lëndimet, a e keni diskutuar këtë me z. Krasniqin?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, prisni.

Avokat i Mbrojtjes, është shumë e papërcaktuar kjo që po thoni. Çfarë lëndimesh e keni fjalën? Kur janë shkaktuar? Kur i kemi diskutuar ne këto lëndime?

Z. GILISSEN: [Përkthim]

PY. Gjatë diskutimit që patët me z. Krasniqi, a ju foli ai për lëndimet që pa tek ju?

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, por do të kërkoj që të dali dëshmitari jashtë nga dhoma se po futemi në themel të çështjes.

Z. Dëshmitar, ju lutem, do të dilni përsëri nën shoqërimin e Sekretares. Faleminderit për durimin.

Na duroni edhe pak.

[Dëshmitari përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po presim të na informojnë që ka dalë Dëshmitari.

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Dëshmitari ka dalë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare.

Z. Prokuror, keni fjalën.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po sugjeroj që në fillim të përcaktojmë kohën, kur ndodhi ky takim, përpara apo pas, pasi Dëshmitari të ishte rrahur. Se besoj se kolegu për këtë e ka fjalën, se atëherë kishte lëndime të dukshme. Pastaj mund ta pyesim dëshmitarin nëse z. Krasniqi e ka pyetur për to. Pra, duhet

të përcaktojmë një herë bazën që të provojmë vlerën e përgjigjes së Dëshmitarit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë desha të thoja dhe unë më përpara. Avokat i Mbrojtjes duhet të provojmë një herë që kishte lëndime, që lëndimet ishin të dukshme dhe nëse z. Krasniqi iu drejtua, foli për këto lëndime, nëse po, çfarë diskutuan. Pra, jemi në të njëjtën mendim.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Më mirë po citoj transkriptin e djeshëm.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, mund të vazhdojmë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po përpara të citojmë transkriptin, ta pyesim Dëshmitarin, mendoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk do të përsërisim pyetje dhe përgjigjet që janë dhënë, ndërkohë. Nëse ai ka thënë diçka për këtë pikë, nuk ka problem ta përsërisim kur të vijë Dëshmitari dhe pastaj të vazhdojmë, kështu?

Në rregull. E shoh që--

Z. GILISSEN: [Përkthim]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po tund kokën në shenjë pohimi.

Sekretare, silleni ju lutem Dëshmitarin.

[Dëshmitari fillon dëshminë përmjes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, a më dëgjon?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Z. Shala, a e dëgjoni Dëshmitarin?

E shoh që pohoni me kokë.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Avokat Mbrojtës, keni fjalën.

Z. GILISSEN: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, dje dhe e kemi në transkriptin e djeshëm, në faqen 92, rreshti 10 e më pas dhe në faqen 94, në rreshtin 18 e tutje, ju po flisnit për një skenë dhune të tmerrshme që kishte dy skena që shkaktuan lëndime në sy, që ju shkaktuan juve lëndime në sy. Po të vinte dikush e t'ju shihte në atë moment, ishin të dukshme këto lëndime tuaja?

PË. Po.

PY. A ju kujtohet një moment kur z. Krasniqi i pa këto lëndimet dhe diskutoi me ju për këtë gjë?

PË. Po.

PY. A mund t'i shpjegoni Trupit Gjykues se ç'ndodhi dhe çfarë diskutuat me z. Krasniqin për këtë, pra, si ndodhi? T'ia shpjegoni Gjykatës.

PË. Ai ma boni pyetje që kush m'ka ra dhe a e kam pa atë person që m'ka ra. I thashë që, jo, nuk e kam pa, nuk e kam njoftë, e kam

pas kryet ulët, për një moment vetëm kur e kam nie dhembjen n'sy.
PY. Faleminderit, është shumë e qartë.
Pra, me këtë doni të thoni se z. Krasniqi nuk kishte pasur dijeni që ju kishin rrahur dhe që ju kishin lënduar, kështu?
PË. Po, kështu është.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Prokuror, më thoni.
Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kundërshtoj. Dëshmitari mund t'i deklarojë faktet siç po i thotë që z. Krasniqi i pyeti për lëndimet nëse vërtet z. Krasniqi nuk e dinte dhe po pyeste, atëherë ky është spekulim. Ai e pyeti për lëndimet dhe kaq mund të thotë ai, Dëshmitari, mendoj unë.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kemi parasysh z. Prokuror, këtë që po thoni. Për procesverbal mund të themi që pyetja mund të bëhet, Dëshmitari mund të thotë atë që mendon se ka ndodhur.
Nëse doni, kur të bëni pyetjet shtesë, mund ta trajtoni, por e kuptoj atë që doni të thoni, Prokuror.
Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, përgjigja e Dëshmitarit ishte shumë e qartë. Kështu që, mund të flas për një temë tjetër.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua të bëj një pyetje: z. Dëshmitar, ku u zhvillua ky diskutim, ku ndodhi, në ç'vend?
DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Ky diskutim ka ndodh në dhomë. Na kemi qenë në dhomë, kurse Xhemshit Krasniqi ka qenë në

derë, te dera.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa herë ju ka vizituar z. Krasniqi, gjatë kohës që keni qenë aty?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Vetëm një herë. Këtë herë na ka pru batanijet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

E kuptuat pyetjen Dëshmitar?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të thoni, po, nëse më kuptuat, kjo është po-ja, për këtë thatë, po?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë dua të marr përgjigje për pyetjen që ju bëra. Domethënë, nëse episodi kur z. Krasniqi ju pyeti për lëndimet ndodhi në të njëjtën ditë që solli batanijet dhe dyshekët aty?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë.

PY. Kam dhe një pyetje për këtë temë, z. Dëshmitar. Pas këtij diskutimi që patët me z. Krasniqi, ju rrahën më, ju rrahu më njeri pas atij diskutimi?

PË. Jo.

PY. Faleminderit shumë.

Dua t’ju bëj një pyetje për atë incidentin me të shtëna që

diskutuam më herët sot. Në transkript, sot, në rreshtin 1, faqja 13 thoni, thoni në një, thatë në një moment që dëgjova një të shtënë.

Sa për t'u sqaruar dhe për t'u siguruar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund ta bëjmë në seancë publike?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa për të verifikuar.

Z. GILISSEN: [Përkthim]

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pyetja nuk është e qartë për mua.

Z. Prokuror.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ja u lë unë në dorë të vendosni, të nderuar, Gjykatës, nëse do ta lejoni këtë pyetje. Por do doja për procesverbal që të thoja diçka, por për këtë duhet të futemi në seancë private. Ju lutem, të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Vazhdoni me pyetjet.

Z. GILISSEN: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, sot na shpjeguat që ju mori në pyetje një burrë që njihej me emrin Osman Kryeziu. Na shpjeguat këtë intervistën që

patët me të dhe ju thatë që vetëm këtë patët, këtë intervistë patët me të. Z. Kryeziu a u befasua me deklaratën që i dhatë ju?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prit. Z. Avokat, për cilën bisedë po flasim, për cilën periudhë kohore? Se ai ka biseduar më shumë se një herë me këtë person konkret.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Do citoj transkriptin. Po ai një bisedë ka pasur me z. Kryeziu. Vetëm një herë e morën në pyetje gjatë kohës që ishte në ndalim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po i ka dhënë, ka thënë se ka folur me të dhe pas luftës. Dhe nuk e bëre konkrete në pyetje për cilin rast e ke fjalën dhe faleminderit për referencën e transkriptit.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Po prisja që të ma jepni referencën. E kam fjalën për intervistën që pati me z. Osman Kryeziu në fabrikën e metalit në Kukës në vitin 1999. Është transkripti i sotëm, faqja 29, rreshtat 11 deri në 14.

PY. Dhe bëhet fjalë për këtë intervistë. Pra, gjatë kësaj interviste që patët lidhur me arsyet pse ju kishin ndaluar në ish-fabrikën e metalit në Kukës. Unë do doja të dija nëse z. Kryeziu u befasua nga përgjigjet që i dhatë ju dhe nga deklarata që bëtë ju?

PË. Po.

PY. Dhe çfarë tha z. Kryeziu? Pra, çfarë tha ai kur dëgjoi përgjigjen tuaj? A komentoi, si reagoi, si reagoi?

PË. Po reagoj normal. Tha që jemi befasuar për çfarë arsye je mrena.

PY. A e dinte ai që ju ishit, a dukej sikur e dinte ai që ishit i ndaluar ju për një muaj? A ngjaso -- a dukej sikur ai e dinte?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një çast, z. Dëshmitar.

Unë s'e kuptoj pyetjen mirë. Ju po thoni, a e dinte ai që ju ishit i ndaluar për një muaj?

Z. GILISSEN: [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. Kryeziu, a e dinte z. Dëshmitar që ju kishit qenë një muaj ndaluar, që kishit një muaj që ishit ndaluar atje?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Nuk e di unë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni, Avokat.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Sa kohë pas intervistës me Osman Kryeziun ju liruan ju? Ju kujtohet? Sa kohë pas kësaj interviste u liruat ju?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Për sa më kujtohet, brenda dy javëve.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të citoj një dokument? SITF--

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fillimisht më informo pse do që ta citosh, që do të thotë, pse duhet ta nxjerrim provën materiale dhe pastaj vendos unë. Edhe pastaj mund t'i japim numrin e referencës Sekretares edhe mund t'ia tregojmë Dëshmitarit.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Në deklaratë dua të lexoj çfarë

ka thënë dëshmitari dhe i saktë ka qenë në përgjigjen lidhur me këtë pyetje. Ai i jep hetuesit, hetuesve informacion shumë të saktë që nuk është dhënë këtu në seancë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra, bëhet fjalë këtu për periudhën kohore nga intervista e deri në lirimin e tij?

Pra, doni t’i rifreskoni kujtesën dëshmitarit.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, absolutisht. Nuk duam të krijojmë asnjë problem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë tani mund t’i jepni referencën Sekretarit.

Z. GILISSEN: [Përkthim] SITF00013047-SITF00013060 RED5. Ndërsa në shqip është 00013075-SITF0001388 RED5, faqja 13.

Faqja 13 dhe anglisht dhe në shqip.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Avokat.

Z. GILISSEN: [Përkthim]

PY. Nuk ka rresht në këtë dokument, por ajo që unë dua të parashtroj është një pjesë që unë mund ta citoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po. Z. Dëshmitar, Avokati do lexojë një fragment nga një deklaratë të mëhershme që keni dhënë ju, dhe aty flisni për periudhën kohore mes bisedës apo diskutimit me z. Kryeziu edhe lirimin tuaj. Për të kuptuar, nëse ju kujtohet, sa kohë, pas sa kohësh jeni liruar.

Avokat, fjala është për ju.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Unë doja të citoja diçka shkurt, në fakt, dhe është diku në mes faqes:

"Ishte shumë i befasuar kur i thashë që ai tha s'e kuptoj pse je këtu". Pyetje: "A jeni intervistuar"?, unë i thashë "Jo" dhe të nesërmen shkova në shtëpi.

Kjo është, pikërisht ajo që dua, për këtë dua që Dëshmitari të më komentojë. Për këtë fjalën e fundit. Për këtë fjalinë e fundit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund ta bëjë pak më konkrete.

Z. Dëshmitar, a ju kujtohet që jeni liruar të nesërmen?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Nuk më kujtohet se unë jam lirue kur është çel dera që ka hi KFOR-i e NATO në Kosovë, atëherë është çel dera dhe kam dalë jashtë unë. Tjetër nuk më kujtohet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni fjalën nëse keni pyetje vijuese.

Z. GILISSEN: [Përkthim]
PY. A ju kujtohet të keni bërë një intervistë *[REDAKTUAR]*?
PË. Nuk mbaj mend. Më kujtohet që kam bo, por nuk muj me mbajt mend.
PY. Faleminderit.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Do kalojmë në një temë tjetër.
PY. Z. Dëshmitar, gjatë intervistës që keni bërë me ZPS-në në vitin 2019, atëherë ju treguan disa fotografi të disa personave, kështu?

PË. Po.

PY. Dhe t'i kërkoja Sekretarit t'ju tregojë një fotografi, një dokument dhe të t'i jap edhe numrin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund ta informoni Trupin Gjykues pse doni që t'ia tregoni këtë dokument?

Z. GILISSEN: [Përkthim] T'i tregoj dëshmitarit nëse e njeh personin në fotografi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në ç'kuadër, në ç'kuadër të akuzave? Në ç'kontekst?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po bëhet fjalë për një person që pretendon se ka qenë i ndaluar në Kukës, në të njëjtën kohë që ka qenë ndaluar edhe Dëshmitari dhe unë do të doja të dija nëse ai e njeh këtë person.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Atëherë Sekretar, vazhdoni.

Z. GILISSEN: [Përkthim] 059341-059350, faqja 10.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë do t'i kisha bërë një pyetje të hapur, z. Avokat.

Z. GILISSEN: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, a e shihni fotografinë përballë?

PË. Po.

PY. Faleminderit. A e njihni këtë person? A mund të na e thoni emrin e këtij personi apo ndonjë informacion për këtë person?

*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat,

Avokat duhet të kalojmë në seancë private për këtë.

Unë do parapëlqeja në seancë private. Sekretar, të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F579*

Avokat, ju na informuat se pothuajse keni mbaruar, por që këtë pjesë, atëherë, do ta sqarojmë pas pushimit.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Pas pushimit nuk kam asgjë tjetër, atëherë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kështu e kuptova edhe unë.

Z. Dëshmitar, do bëjnë një pushim tani, një orë e gjysmë, do kthehemi në orën 14.30. Përpara se të dilni nga vendi ku ndodheni do ju lutesha Prokurorisë të më informojë nëse kanë pyetje vijuese.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Varet si do të shkojë edhe kjo pjesa e fundit. Mund të kemi një ose dy pyetje lidhur me këtë, përndryshe nuk parashikojmë të kemi gjë tjetër shtesë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo na duhet për llogaritje që të informojmë edhe dëshmitarin se si do jetë pasditja.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk besoj se do kem më shumë se 10-15 minuta në qoftë se kam ndonjë pyetje, por edhe më pak se aq ka të ngjarë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësi i Viktimave dhe ju keni mundësi të bëni pyetje.

Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi asnjë pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë, z. Dëshmitar, siç ju thashë, do të vijojmë pas orës 14.30 dhe mendoj se do ta mbyllim, do mbarojmë para se të, para orarit zyrtar në sallën e gjyqit. Dhe ju uroj pushim të mbarë e të pushoni pak. Faleminderit.

Sekretare a mund ta shoqëroni Dëshmitarin jashtë ambientit?

[Dëshmitari përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Dëshmitari ka dalë nga salla, nga ambienti.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Para pushimit do i lutesha Sekretarit të na japi numrat ERN që ia dhënë materialeve që ka shënuar Dëshmitari gjatë pyetjeve që i bëri ZPS-ja.

Z. AOUINI: [Përkthim] A mund ta bëjmë në seancë publike këtë, sepse jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, po. Shumë mirë.

Sekretar, mund të kalojmë në seancë publike, ju lutem.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. A mund të na jepni numrat ERN para se të bëjmë pushimin. Pra, numrat ERN që iu janë dhënë materialeve që shënoi Dëshmitari gjatë pyetjeve nga Prokuroria.

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Më 2 maj 2023 Dëshmitari TW-11, gjatë pyetjeve kryesore bëri shënime në materialet, ERN 074390 dhe imazhi i shënuar ka marrë nr. REG00951 dhe është ngarkuar nga Njësia Përgjegjëse në Legal Workflow.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Kthehemi në orën 14.30. Drekë të mbarë.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.03.

--- Seanca rifillon ne orën 14.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni, ju lutem.

Mirë se keni ardhur përsëri, dhe me sa shoh janë të njëjtën persona, si në Zyrën e Prokurorisë, Mbrojtësi i Viktimave, nga Mbrojtja, zoti Shala është i pranishëm.

Më dëgjoni mirë, zoti Shala?

Jam unë e vetmja që nuk dëgjoj gjë?

Zoti Shala, nuk dëgjuam gjë. Provojeni edhe një herë, ju lutem.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, dëgjoj mirë, e nderuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani ju dëgjova edhe unë. Faleminderit.

Pra jemi të njëjtët. Mund të vazhdojmë me pyetjet e Mbrojtjes.

Avokati i Mbrojtjes, i keni për të na i treguar rreshtat e versionit shqip, që i korrespondon versionit anglisht, që të përkthehet nga ekipi i përkthimit?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Janë referencat që kam dhënë më përpara, që do të thotë faqja 27.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do t'i kërkoj sekretarit të paraqesë në ekran të dy versionet: në shqip dhe në anglisht, me qëllim që të mund t'i krahasojmë gjatë kohës që po përkthehen. Ju lutem na jepni versionin në anglisht.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Numri është 059351-TR-ET, Pjesa 2 dhe mund të fillojmë nga rreshti i 4 deri në rreshtin 15.

Në versionin shqip mund të fillojmë nga rreshti 17 deri në rreshtin 3. Problemi është që në versionin shqip, ndryshon faqja. Kemi 27-ën dhe 28-ën dhe shpresoj që të jem i qartë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e

fillojmë në rreshtin 17 në faqen 27 dhe vazhdojë pastaj me faqen 28. Po sa që të shfaqen në ekran.

Tani do t'i kthehem ekipit të përkthimit. Zonja apo zotëri përkthyes, a është informacion i mjaftueshëm që të përktheni versionin shqip?

Atëherë vazhdoni po sa që të jeni gati.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që të jem e ndershme, nuk e krahasova dot përkthimin me gojë që dëgjuam tani gjatë gjithë kohës me tekstin në anglisht sepse nuk e shikoja në ekran. Prandaj, ftoj ZPS-në apo Mbrojtjen të shprehen në qoftë se kanë gjetur ndonjë mospërputhje në tekstin në anglisht, në përkthimin që ne dëgjuam.

Ndërkohë, do ta krahasojmë me atë që dëgjuam.

E shoh që është ngritur Avokati i Mbrojtjes. Pastaj më vonë të t'ja jap Prokurorisë.

Ju lutem, Avokat Mbrojtës.

Z. AOUINI: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, të nderuar Gjykatës, nuk pati ndonjë mospërputhje të madhe. Një gjë vura re: që përkthyesja tha "nuk e pashë" por po të shohim faqen 27, te rreshti 7, transkriptimi në anglisht thotë "nuk e shihnim njëri-tjetrin mirë". E vetmja mospërputhje për mua që vura re ishte kjo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Doni të shtoni gjë ju të Prokurorisë?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të

shtuar. Edhe ne kemi të njëjtin mendim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

A bëhet kjo shkas që ju t'i bëni pyetje të tjera dëshmitarit pasi ta ftoj të futet në sallë?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Për mua është shumë e qartë, por ne e morëm përgjigjen nga dëshmitari përpara pushimit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, po, por ne dëgjuam edhe një herë përkthimin. Sepse teksti në anglisht mund të ishte paksa i ndryshëm dhe e konfirmuam që nuk ka arsye që të bëni ndonjë pyetje tjetër.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mund ta riformuloj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, jo. Varet nga ju. S'ka nevojë. Në qoftë se ju jeni i kënaqur, nuk ka nevojë të vazhdoni me pyetjet të tjera.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë jam i kënaqur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani i lutem sekretares ta sjelli dëshmitarin në dhomën ku jep dëshminë.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Po vë re që dokumenti ende vazhdon të jetë në ekran.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Të hiqet dokumenti.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ndërkohë, nuk e shoh të shkruar në transkriptim që z. Gilissen thotë që është i kënaqur. Ndoshta

s'ka qenë mikrofoni i hapur, por shoh që përgjigja nuk është shkruar në transkriptim.

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se keni ardhur përsëri, z. Dëshmitar. Më dëgjoni mirë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Kur ju po vinit aty, Avokati i Mbrojtjes ngriti një çështje lidhur me transkriptimin. Përpara se të vazhdojmë me pyetjet, do të përpiqemi një herë ta zgjidhim këtë çështje.

Avokati i Mbrojtjes, po kthehemi te momenti para pushimit. Ja ta gjej këtu.

A mund të na vini në dukje, avokat, se ku në ç'pjesë të transkriptimit mungon ajo përgjigja e dëshmitarit.

Z. AOUINI: [Përkthim] Në qoftë se e kuptova mirë, në faqen 72, rreshti 8. U bë pyetja e z. Gilissen dhe pas kësaj deri te pushimi, pati një shkëmbim pyetjesh e përgjigjesh, pro nuk është shënuar përgjigja e dëshmitarit.

Mund të më korrigjoni, por me sa shoh unë këtu, nuk është.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rreshtin 12 dhe 13, pa lexuar me zë të lartë, apo është citim ky?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është citim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Unë po e shikoj transkriptimin për të parë nëse mungon ndonjë përgjigje.

As unë nuk e shoh përgjigjen. Z. Prokuror, e keni parë ju?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo. Përgjigja e fundit, me sa shoh, është ajo që i është përgjigjur pyetjes suaj, në faqen 71, rreshti 21.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Avokat i Mbrojtjes, mënyra më praktike do të ishte që t'ja bënit pyetjen edhe një herë. Nëse e mbaj mend mirë, kërkuat që në ekran të vihej një dokument. Pra do të sugjeroja që ta shfaqin edhe një herë dokumentin dhe ju të përsërisni pyetjen.

Sekretar, ju lutem, nxirrni dy dokumentet që sapo i kishim më përpara, dhe pastaj në këtë pjesë do të futemi në seancë private.

Të kalojmë në seancë private, sekretar.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F579*

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni, avokati i Mbrojtjes.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mënyra më e mirë është që ta përsëris pyetjen që i bëra dëshmitarit, që të jemi të sigurt

që të mos bëjmë ndonjë gabim.

PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Pra, po flisnim për një deklaratë që keni dhënë ju, dhe po e citoj pjesën e përgjigjes për një person që e pamë në fotografi dhe po citoj fragmentin e deklaratës. Pyetja që është bërë është:

"E njihni këtë burrë? Ka qenë me ju në kohën që keni qenë në Kukës?"

Përgjigja jote ishte:

"Nuk e kam parë ndonjëherë"

Dhe pyetja ime është: a e konfirmoni këtë?

Pra "Përveç dy romëve – ke thënë – nuk kam parë njeri tjetër". A e konfirmon këtë?

PË. Po.

PY. Faleminderit shumë.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Besoj që është e qartë, faleminderit. kjo ishte pyetja e fundit që kemi ne si palë Mbrojtëse.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nëse më lejoni, do të kishte qenë më e drejtë në qoftë se dëshmitarit do t'i lexohej e gjithë pjesa që u lexua përpara, sepse në fillim kishte diçka tjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të keni parë një ngurrim të vogël, sepse po i përsërisim pyetjet, por mund ta vazhdoni kur të vijë radha juaj, duke u nisu nga kjo pikë.

Në rregull. Z. dëshmitar, Mbrojtja i ka përfunduar për momentin pyetjet e veta dhe do të shohim nëse zyra e Prokurorisë do të ketë ndonjë pyetje tjetër.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

Z. Prokuror, doni bëni disa pyetje të tjera?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, nja apo dy pyetje të tjera.

Pyetje vijuese nga z. De Minicis:

Z. De MINICIS: [Përkthim]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Prokuror, jemi në seancë private. Doni të kalojmë në seancë publike.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, do të dëshiroj të vazhdojmë të jemi në seancë private sepse dua të diskutojmë me dëshmitarin një episod që ka të bëjë me *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni ju lutem.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, kam vetëm nja dy pyetje.

Gjatë ditës së sotme, në fillim, në faqen 16 deri në faqen 22, diskutuam gjerë e gjatë për kohën kur dëgjuat të shtënën, kur dy persona ishin plagosur në dhomë dhe që njëri prej tyre vdiq.

Më vonë diskutuam një moment, një rast, kur Xhemshit Krasniqi erdhi në dhomë dhe pyeti për dyshekët dhe për lëndimet që kishe ti?

A të kujtohet që e bëmë këtë diskutim sot, z. Dëshmitar? Këto dy momente? Këto dy episode?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] E humbën dëshmitarin, u ndërpre lidhja.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jam e sigurt që teknikët po merren me këtë punë.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po e rilidhim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka njeri aty? Zonja Sekretare, a jeni aty?

Duhet të tregojmë pak durim, jam e sigurt se do të zgjidhet shumë shpejt.

Kemi pasur një lidhje të shkëlqyer për këto dy ditë e gjysmë, jam shumë krenare se si është bërë e mundur kjo nga ana teknike.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit për durimin tuaj, u rivendos lidhja.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. dëshmitar, më dëgjoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Kishim një problem teknik dhe na u shkëput lidhja me

vendin ku jeni, pra me ju. Por tani u rivendos, kështu që mund të vazhdojmë.

Po ja jap fjalën përsëri Prokurorit, i cili do të vazhdojë me ato pyetjet që ka.

Keni fjalën, z. Prokuror.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. Dëshmitar, doja t'ju pyesja. Pra ishte ai episodi ku u dëgjuan të shtëna, ku njëri prej dy personave vdiq, dhe pastaj ishte ai çasti kur z. Krasniqi erdhi në dhomë, pyeti për dyshekët dhe për lëndimet e tua.

Ky episodi, kur Xhemshit Krasniqi erdhi në dhomë dhe ishte hera e parë, siç thatë ju, që e shihnit, kjo ndodhi *[REDAKTUAR]*

PË. [E padëgjueshme]

Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund të shohim atë fotografinë që po diskutonim më herët dhe do të jap ERN: 059341 deri në 059350 dhe është faqja e fundit e kësaj prove materiale.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhashë miratimin.

Z. AOUINI: [Përkthim] ERN-ja duhet të fillojë nga 41-shi, në qoftë se nuk e kam gabim.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit. Faqja e fundit.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Në qoftë se ju ndërpres, ne nuk shohim asnjë provë materiale.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Tani e shohim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Z. dëshmitar, është pyetja e fundit që kam lidhur me këtë temë.

Kur ju intervistuam në vitin 2019 dhe ua treguam këtë fotografi, ju thatë:

"Ka mundësi që të ketë qenë *[REDAKTUAR]*, por nuk e jam dot një qind për qind i sigurt."

Dhe ne vazhduam dhe ju pyetëm nëse e keni parë në Kukës në atë kohë dhe ju thatë:

"Nuk e kam parë. Përveç dy romëve, nuk kam njohur njeri tjetër."

Sot, përveç dy romëve, ju njohët edhe dy veta tjerë në fotografi. Ishin ata *[REDAKTUAR]* Kështu është?

PË. Po.

PY. Më herët sot --

Dhe e kam fjalën për faqen 71 të transkriptimit, të nderuar Gjykatës --

PY. Kur ua treguam këtë fotografi, njëlloj siç i the Prokurorisë atëherë, edhe sot –

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në çfarë faqe është të transkriptimit?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Fillon në faqen 70, te 70-a në fakt.

PY. Ti the:

"Nuk e njoh emrin."

Por pastaj vazhdove:

"Dëgjova se ishte *[REDAKTUAR]*".

Rreshti 15.

PY. Pastaj Gjykatësja të bëri disa pyetje, dhe pastaj në fund, të pyeti Gjykatësja:

"Në rregull. Ti po thua "ai – mësuesi pra – ishte me ty në dhomën ku të mbanin ata. Ishte një nga personat që ishte aty me ty? Këtë po thoni?"

Dhe ju u përgjigjët: "Po".

Krahasuar me ato që i ke thënë Prokurorisë në vitin 2019 që nuk e njihje këtë, ka një farë paqartësie. Sepse sot the ndryshe. Pra çdo do të thuash, ky personi në fotografi ka qenë i ndaluar me ty në Kukës në të njëjtën dhomë në atë kohë, siç i the Gjykatëses?

Z. AOUINI: [Përkthim] Kjo është pyetje orientuese.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, nuk është pyetje orientuese. Është pyetje e mbyllur por është një pyetje që unë do ta lejoj, duke e marrë parasysh se si shkuan pyetjet sot.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Pra pyetja është a e njihni këtë burrin në fotografi dhe a e keni parë më parë?

PË. Mbasi e kam parë në fotografi më është kujtuar që e kam parë edhe në dhomë aty, por nuk ka qenë gjatë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, nuk kam pyetjet të tjera.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

Mbrojtësi i Viktimave na njoftoi që nuk ka pyetje dhe nuk po shoh ndonjë lëvizje nga ana e tyre.

Avokati Mbrojtës, a keni ndonjë pyetje vijuese për të sqaruar? Ndonjë aspekt që u tha te pyetjet shtesë?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, një pyetje për të njëjtën çështje që sapo diskutuam. Siç tha edhe Prokurori, dëshmitari na tha se ai ka qenë *[REDAKTUAR]*.

Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Gillisen

Z. GILLISEN: [Përkthim]

PY. Dhe më duhet të pyes, nga kush e morët vesh, nga kush e mësuat ju? Pra, kjo është pyetja ime: nga kush e mësuat ju këtë që ai ka qenë *[REDAKTUAR]*? Kush ua tha ju këtë?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse nuk e kam gabim, kjo pyetje ju drejtuar një herë dhe ai ju përgjigj. Ai tha: kur ishte atje e mësoi. Ju doni të mëso nga kush? Mirë, atëherë.

Z. GILISSEN: [Përkthim]

PY. Nga kush e keni dëgjuar që ishte *[REDAKTUAR]*?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, a ju kujtohet nga kush e keni dëgjuar ju që ai ka qenë *[REDAKTUAR]*?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Kam dëgjuar në dhomë, ku kanë biseduar. Kush a ka njohur nuk e di. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë e qartë. Kaq kisha. Ju faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, ju drejtoi pyetje Zyra e Prokurorit të Specializuar, Ekipi i Mbrojtjes. Tani e ka radhën Trupi Gjykues. Pra Gjykatësit t'ju bëjnë ndonjë pyetje. Dhe shpresojmë që të sqarojmë më shumë lidhur me ato që keni thënë dje dhe sot, si dhe lidhur me deklaratat e mëparshme që keni dhënë.

Jemi në seancë private dhe duhet të mbetemi në seancë private për shkak të natyrës së pyetjeve, sepse mund të shërbejnë për të zbuluar identitetin e dëshmitarit.

Pyetje nga Trupi Gjykues:

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. dëshmitar, dje ju na thatë se keni qenë në kamp, dhe atje, kur ishit në kamp, dy persona të thanë të shkoje me ta dhe të çuan

në një gjë që dukej si fabrikë, në Kukës. Ky është transkriptimi i përkohshëm, faqja 1187, rreshtat 5 deri në 10.

Tani pyetja shtrohet: A mund t'i shpjegoni Trupit Gjykues pse shkuat ju me ta? Pse pranove, pse shkuat ju me ta?

PË. Po, unë shkova se më thanë duhesh me dhënë një intervistë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] U ndjetë i detyruar të shkonit?

PË. Jo, vetëm më thanë që duhesh me ardhë me neve me dhanë një deklaratë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra nuk ishe i detyruar? Po i kërcënuar u ndjeve?

PË. Jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po përpiqem të kuptoj pse pranove të shkoje, pse nuk qëndrove në kamp? Në qoftë se nuk ishe i detyruar të shkoje me ta, pse pranove të shkoje?

PË. Po pranova se nuk e dija për çka a në pyetje, për çfarë deklarate, edhe atëherë u detyrova me shkue.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra u ndjeve i detyruar. A mendove se mund t'ju thoshe "Jo, jo, nuk do të vij. DO të rri këtu"?

PË. Jo, nuk mendova hiç me ju thanë që do rri këtu, por me të thënën e tyre, unë u nisa me ta. Me kerr shkuam.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po a

e kupton thelbin e pyetjes time? Se unë po përpiqem të kuptoj pse shkove. A kishte -- a të bënë ndonjë presion? Të ushtruan ndonjë presion?

PË. Jo, kurrfarë presioni.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokati, keni pyetje.

Z. AOUINI: [Përkthim] A mund ta bëjmë në seancë publike këtë?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E mendova unë, por nuk e dija se çfarë përgjigje do të jepte. Por tani e dimë çfarë tha, dhe e dimë që mund ta kishim bërë në seancë publike, por s'ishte e qartë më herët.

Do t'i rishikojmë materialet dhe do të shohim se çfarë mund të nxjerrim në publik. Kjo është diçka që vlen për të gjitha transkriptimet.

Për ta sqaruar më tej, do flasim edhe për kampin. Donim të ishim të sigurt. Megjithatë e vlerësoj që të gjithë keni parasysh interesin e publikut.

Z. Dëshmitar, pyetja tjetër.

Dje na thatë se ju morën një herë në pyetje në fabrikën në Kukës dhe në transkriptim kjo reflektohet në faqen 1222, rreshtat 19 dhe 20. Dhe disa herë diskutuam mbi arsyet pse ju mbajtën, por unë do të doja të dija se për çfarë ju pyetën. A mund të na tregoni doçka më shumë lidhur me këtë? Pra çfarë pyetjesh të bënë?

PË. Po pyetje më bëri ai gjykatësi "Ku kam punu, çka kam punue, dhe në kohë të luftës ku kam qenë, dhe çka kam veprue në atë kohë".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po. Çfarë i the gjyqtarit lidhur me atë që kishit bërë gjatë luftës, a ju kujtohet çfarë i the, çfarë kishe bërë gjatë luftës?

PË. Po më kujtohet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund të na tregoni diçka më shumë lidhur me këtë?

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Që këto i kam thanë gjykatësit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A kishte ndonjë arsye pse ja the këtë gjykatësit?

PË. Arsye vetëm çka ky pse më pyeti, desha t'i tregoj që çka kam veprue në kohë të luftës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mendoje se ata, edhe me "ata", pra kur them "ata" e kam fjalën gjykatësi që ju mori në pyetje, dhe të tjerët që të mbajtën, të ndaluan në fabrikë. Pra a mendon se ata dyshonin se ti ishe

spiun?

PË. Nuk e di, ka mundësi, por nuk e di. Nuk e di.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, ju i thatë që nuk ishit spiun?

PË. Po, i thashë me ato fjalë, çka kam përjetu dhe çka kam vepru unë në kohën e luftës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do lutesha që të nxirrnim deklaratën 059351TR-ET Pjesa 2, faqja 21, rreshti 12, 22 dhe 23. Ndërsa shqipja, është po ashtu faqe 21, rreshti 17, dhe në faqen 22, rreshtat 6 e 7.

Nëse mund t'i nxjerrim të tre në ekran.

Sekretar, në këtë rast do ju lutesha që të nxirrnit faqen 22, rreshtat 6 dhe 7.

Z. Dëshmitar, ju thoni, keni thënë një herë në një rast të mëparshëm:

"I kam thënë Gjykatësit në këtë rast se unë nuk isha spiun..."

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Dhe ju e përsërisni, ja keni përsëritur gjykatësit. Ju pyetën: "A mund të shpjegoni se për çfarë arsye e keni treguar këtë" ju pyetën nga Prokuroria dhe kur thoni "atij" bëhet fjalë për gjykatësin. Ju thoni është Prokurori i UÇK-së:

"...për t'i thënë që unë nuk isha spiun, spiuni i ushtrisë, spiuni i UÇK-së" dhe unë po ju pyes edhe një herë, a

kishte ndonjë arsye pse i thatë ju atij q nuk ishit spiun. Cila qe arsyeja që i thatë që nuk ishit spiun?

PË. Po, arsye ishe për ta vërtetuar, që nuk isha. Unë isha i pastër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po pse, të kishin dhënë përshtypjen që mendonin tjetër gjë për ju?

PË. Jo, por mua më shkonte mendja se mos është ai problem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Mjafton, z. Dëshmitar.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës

këshillohen]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne i mbaruam pyetjet nga ana e palëve. Bëmë disa pyetje në seancë private - Trupi Gjykues. Kemi edhe disa pyetje të tjera që do të jenë përsëri nga Trupi Gjykues, po në seancë private.

Sekretar, a mund të kalojmë sërish në seancë private, ju lutem?

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F579*

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, tani do ja jap fjalën kolegut në të majtën time, gjykatësit Bitti, i cili do të bëjë disa pyetje të tjera.

Fjala është për ju.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

Unë do të filloj me një pyetje të thjeshtë lidhur me një temë që u përmend nga kolegu, që ka të bëjë me momentin kur ju morën nga kampi dhe ju çuan në fabrikën e metalit në Kukës. E diskutuam edhe dje, në faqen 1187, rreshtat 3 dhe 10.

Dy pyetje të shkurtra, sepse kolegia i shtroi. Z. Dëshmitar, a ju tregua ndonjë dokument zyrtar asokohe kur erdhën këta persona në kamp? Pra, a ju paraqitën një dokument zyrtar, një fletë thirrje, një dokument?

PË. Jo.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Ata personat që erdhën, a ju thanë se ju ishit i dyshuar për kryerjen e ndonjë krimi?

PË. Jo.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

Tani do kaloj te tema e dytë dhe do përpiqem ta bëj në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretar, a mund të kalojmë në seancë publike, ju lutem.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Z. Dëshmitar, do të flas për një temë tjetër dhe kjo ka të bëjë me momentin kur ju mbajtën të ndaluar. Do të doja t'ju pyesja, sa persona ishin të ndaluar bashkë me ju?

Dje, në faqen 70 të transkriptimit të përkohshëm, rreshti 18 ju thatë se kur shkuat në dhomë, patë shtatë deri në tetë persona në të njëjtën dhomë ku ju mbajtën edhe ju.

Dhe pyetja ime është: këto shtatë-tetë persona që ishin atje kur shkuat ju qëndruan gjatë gjithë kohës që ishit edhe ju i ndaluar atje? Pra, të njëjtët persona qëndruan edhe gjatë kohës që ishit edhe ju i ndaluar atje?

PË. Jo.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] U liruan disa prej personave nga kjo dhomë gjatë kohës që ishit ju i ndaluar dhe a sollën të ndaluar të tjerë gjatë kësaj kohe?

PË. Jo, nja dy kanë dalë, të tjerë më nuk kam vërejtur. Ndoshta para meje ka pasur. Nuk e di.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Për sqarim, ishin shtatë-tetë të pranishëm në momentin që shkuat ju, kështu?

PË. Po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Lidhur me këtë, dua t'ju sjell në kujtesë një deklaratë që i keni dhënë ZPS-së, që është 059351-TR-ET, Pjesa 3, është faqja 17, rreshtat 8 dhe 9. Për shqipen do i jap referencat më vonë, ju kërkoj ndjesë.

Dhe ju aty thoni, në fakt ju thanë juve se:

"Në deklaratën e mëparshme keni thënë që kur ishit i ndaluar, erdhën disa të burgosur të rinj. Dhe disa u larguan".

A e mbani mend që keni thënë kështu? Se erdhën disa të burgosur të rinj në dhomën e ndalimit kurse disa nga grupi i parë u larguan. A të kujtohet ta kesh thënë këtë?

Z. Dëshmitar, doni që tua përsëris pyetjen apo...

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ka problem me lidhjen.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Ju shohim dhe ju dëgjojmë tani.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Z. Dëshmitar, dukeni pak i lodhur. Nuk do të zgjasin shumë pyetjet e mia dhe faleminderit për durimin.

Po e përsëris pyetjen. Në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së keni thënë që kur ishit i ndaluar, erdhën disa të burgosur të rinj dhe disa nga grupi i parë u larguan. A të kujtohet ta kesh thënë këtë, që gjatë kohës që ishe i larguar, ca largoheshin, por vinin të tjerë?

PË. Po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Në rregull. A ju kujtohet nëse kishte një ndërrim të të burgosurve? Sa veta ju kujtohet? Pra sa veta janë larguar, dhe sa kanë ardhur? A ju kujtohet?

PË. Jo, nuk më kujtohet.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit shumë. Kam edhe një pyetjet të fundit.

Ju na thatë që në momentin që arritët aty, duke përfshirë edhe ty, ishin tetë apo nëntë veta. Gjatë kohës që keni qenë i ndaluar aty, ka ndodhur që keni qenë më shumë se tetë apo nëntë veta?

PË. Jo, jo. Nuk kemi qenë kaq -- përafërsisht aq kemi qenë.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit shumë.

Tani do të kalojmë në një temë tjetër që lidhet me ato që thatë lidhur me ata romët, që ishin të ndaluar bashkë me ju.

Në faqen 1219, rreshti 6 deri në 13 dje keni thënë:

"Vëllezërit roma dilnin jashtë për të bërë punë".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretar, të kalojmë në seancë private, ju lutem.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] E kontrolluam dje dosjen tonë --

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F579*

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] E kontrolluam dosjen tonë dhe nuk gjetëm asnjë redaktim te vëllezërit romë. Doja që tua sqaroja këtë pikë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne nuk e diskutuam -- nuk e kuptova.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Duam të themi që vëllezërit romë nuk janë dëshmitarë të mbrojtur dhe nuk kemi dijeni përse identiteti i tyre duhet të mos zbulohet në këtë proces.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ideja është që dëshmitari do të flasë për praninë e tij në dhomën ku ishin edhe ata, dhe prandaj kemi frikë se mos identifikohet. Por nëse mundemi ta zbulojmë këtë fakt në një moment të mëvonshëm, do ta bëjmë. Por ju faleminderit që e ngritët.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

Mbase fillimin mund ta bëj në seancë private, pastaj kur të bëj pyetje më të përgjithshme për kushtet e këtyre romëve, mund të kalojmë në seancë publike.

Në faqen 1219, rreshti 6 deri në 13, thatë që:

"Vëllezërit romë dilnin jashtë për të bërë punë".

Dhe pastaj thatë që:

"Pastronin oborrin dhe ktheheshin përsëri në dhomë."

Pyetja e parë është kjo, z. dëshmitar: Vetëm romëve ju kërkohej të bënin këto punë? Vetëm romëve?

PË. Po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] A mund të më shpjegoni pse vetëm romëve u thoshin të bënin këtë punë?

PË. Nuk e di edhe vetë.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] I trajtonin në mënyrë të veçantë këta romët në këtë qendër ndalimi?

PË. Jo, deri sa kam qenë me ta jo, të paktën.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Sepse dje në faqen 1220, rreshti 6 thatë:

"Vëllezërit romë u rrahën më shumë me shkopinj gome".

Mund të na shpjegoni pse ata i rrihnin më shumë?

PË. Nuk e di, nuk e di edhe vetë. As vetë nuk e di se pse, për çfarë arsye.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Kur rojet ose njerëz të tjerë binin në dhomën ku ishit u të ndaluar, romëve u drejtoheshin në mënyrë tjetër nga ju të tjerët?

PË. Jo.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit shumë. Tani do t'ju pyes për diçka tjetër dhe po vij te fundi i pyetjeve që kam.

Është një temë që u prek dje kur thatë, dhe është faqja 1222, rreshti 2, fillon. Ju thatë:

"Të gjithë ne që ishim aty në dhomë rriheshim, një nga një, pa dallim."

Por në të njëjtën kohë në faqen 1220 thatë që ishit me fytyrë nga muri nga zidi. Kam një pyetje -- dhe për këtë arsye nuk i njihnit njerëzit që ju rrihnin, që i rrihnin të ndaluarit. Lidhur me këto të rrahurat brenda dhomës, a e dëgjuat që të bashkëvuajtësit e tjerë të bërtisnin, të ankoheshin, të qaheshin kur po i rrihnin?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Sekretar.

E shoh që u rivendos lidhja.

Z. Dëshmitar, duro edhe pak. Pothuaj se kemi ardhur në fund. Më dëgjon mirë?

E shoh që po tund kokën.

Vazhdoni.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

Pra, ju nuk mund t'i shihnit apo t'i njihnit njerëzit që ju rrihnin. Po britma, ankesat e bashkëvuajtësve në dhomë, ai i dëgjonit?

PË. Ndonjë po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] A e dëgjonin zhurmën e të rrahurave? Pra kur ju rrihnin, e dëgjonin zhurmën?

PË. Po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit shumë.

Tani kam temën e fundit dhe pak minuta kemi. Kjo ka të bëjë me atë që ka ndodhur përjashta. Të kalojë në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretar, të kalojmë në seancë publike ju lutem.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Keni fjalën.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Z. Dëshmitar, tani do të flasim për atë që ka ndodhur jashtë dhomës ku mbaheshit i ndaluar.

Dje, në faqen 1222, rreshtat 19 deri në 24 keni thënë, kur ju pyetën:

"Ju nxirrnin nga dhoma për t'ju marrë në pyetje?"

Dhe ju u përgjigjët:

"Një herë".

"Kush nga njerëzit është marrë për pyetje?"

"Na merrnin nga dhoma dhe na çonin diku tjetër".

Pyetja që kam është kjo: e dini çka ndodhur me personat e tjerë të ndaluar kur i nxirrnin andej dhe i çonin në një vend tjetër?

PË. Jo, nuk e dija. Nuk dija gjë.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] A dëgjuat të bërtitura, qarje, ankesa?

PË. Jo, jashtë dhome jo, s'kam dëgjuar gjë.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Kur ktheheshin përsëri në dhomë, çfarë shihnit mbas pyetjeve që i bënin jashtë? Shihnit ndonjë gjë te ata?

PË. Unë për vete nuk kam mujt me pa, me vërejt, se ka qenë errët, natë.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Për tua freskuar kujtesën, do të shohim një dokument, dhe do të jap referencën. Është dokumenti SITF00013047 dhe vazhdon deri në faqen 60, dhe do të pyes për faqen -- që në ekran të venë faqen 13, që është SITF00013059.

Këtë e keni thënë *[REDAKTUAR]*. Dhe po citoj këtë qe keni thënë dhe do ju pyes nëse e mbani mend. Nëse duke ua lexuar, do t'ju kujtohet.

"Kur më pyesin, e dija që shpresonin do të më merrnin në pyetje gjatë ditës, sepse mendimi i të marrit në pyetje natën ishte i frikshëm. Sepse ata që merreshin në pyetje natën, kur vinin, kur ktheheshin në dhomë ishte diçka jo për tu pasur zili".

Pastaj ju pyetëm "Përse" dhe ju keni thënë:

"Ishin rrahur kaq shumë, sa mezi qëndronin në këmbë. Ishin më shumë se ishin rrahur".

A ju kujtohen këto fjalë, z. Dëshmitar?

PË. Po, më kujtohen.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Pra, është e saktë që kur ktheheshin, ishin në një gjendje që s'ishte për t'ja pasur zilinë?

PË. Po, ashtu ishte, por nuk i shihnim natën se terr. Vetëm i dëgjonim çka folshin mes vedit, shoq me shoq.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Por mënyra, kur i shihje ashtu, kur ktheheshin, dhe ishin aq të rrahur sa mezi mbaheshin në këmbë, besoj që, që t'i thuash këto fjalë, duhet të kesh parë diçka te ata, ose atë kohë ose në mëngjesin tjetër. kam të drejtë të them kështu?

PË. Po, por vetëm në mëngjes na kemi mujt me vërejt.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Pra, ata ishin në gjendje të tillë që ju kishit frikë t'i shikonit ashtu siç ishin. A është kështu, z. Dëshmitar?

PË. Po, e vërtetë është.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Në rregull. Edhe nja dy hollësi. Do të thotë kjo se kishin shenja, kishin lëndime, gjak në trup? A mund ta përshkruash pak më shumë se si ishin? Gjendjen e tyre?

PË. Jo, nuk kam vërejtur kurrfarë gjaku. Kështu, kah ka ndjerë dhembje në trup. Gjak nuk kam vërejtur.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Po shenja në fytyrë apo në trup, si mavijosje për shembull?

PË. Në fytyrë jo. Në trup s'kam mujt me pa.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] A ishin në gjendje të rrinin në këmbë? Të qëndronin në këmbë?

PË. Po, në mëngjes po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit shumë për durimin. Mbarova, kaq pyetje kisha. Faleminderit shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Po shikoj kolegët e anës së djathtë. Keni ndonjë pyetje?

Z. Dëshmitar, Do t'ja jap fjalën gjykatësit Mikula, në anën e djathtë timen.

GJYKATËS MIKULA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, a mund të thoni kohën që ka kaluar nga e shtëna, nga sjellja e personave të lënduar dhe prania e doktorit. Janë përmendur disa herë këto ngjarje, në faqen 12, rreshti 12; faqe 10, rreshti 23; faqja 20, rreshti 18 i transkriptimit të përkohshëm. Pra sa kohë ka kaluar nga një ngjarje te tjetra?

PË. Po nuk mbaj mend. Brenda kohës, brenda kohës, jo shumë gjatë.

GJYKATËS MIKULA: [Përkthim] Dhe një pyetje tjetër.

Nga e kuptove që ishte ky personi mjek? Dhe pe ndonjë ndërhyrje, ndonjë veprim që bëri ky mjeku aty?

PË. Po, qe si zakonisht me mantel të bardhë, dhe ja lidhi plagën. Çka bani, nuk e di.

GJYKATËS MIKULA: [Përkthim] Faleminderit shumë.

Faleminderit, zonja Kryetare.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. dëshmitar, kemi ardhur në fund të dëshmisë suaj dhe dua t'ju falënderoj për përpjekjen që bëtë për të dhënë këtë dëshmi. Jam e sigurt që do të na ndihmojë ne në punën tonë për të gjetur të vërtetën. Edhe një herë ju falënderoj shumë.

Sekretarja do t'ju shoqërojë të dilni nga dhoma dhe dua t'ju kujtoj që të mos i diskutoni këto që deponuat këtu në këtë gjykatë me askënd.

Kalofshi mirë.

[Dëshmitari përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretar, ndërpriteni lidhjen.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Lidhja është shkëputur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë.

Përpara se t'u jap fjalën palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave nëse duan të ngrenë ndonjë çështje me Trupin Gjykues, dua t'ju informoj se nesër do ta përdorim ditën këtu në gjykatë, do të japim disa urdhra me gojë. Nesër në orën 14.00 në sallën e gjyqit, pra, q të mund të japim disa urdhra me gojë për çështje të ndryshme që pritet të vendoset nga ky Trup Gjykues.

Shumë mirë, ju të Prokurorisë a keni ndonjë çështje që

doni ta ngrini me trupin gjykues?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësi i Viktimave?

Z. LAWS: [Përkthim] Po. Faleminderit. Kemi një propozim që e kam diskutuar me kolegët e ZPS-së dhe me ekipin e Mbrojtjes, për të thjeshtuar procedurat lidhur me prezantimin e materialeve, paraqitjen e materialeve.

Në çështjen 06 u dha një urdhër me gojë në prill të këtij të këtij viti, dhe në transkriptim është faqja 2813, rreshtat 17 deri në 21. Urdhri ishte ky që: Palët dhe pjesëmarrësit të fusin në sistem vetëm materiale që janë plus, materiale shtesë të listës së materialeve të palëve. Për momentin sistemi është i tillë që lista e paraqitjeve bëhet nga pala thirrëse dhe shpesh ne e riprodhojmë, e ndjekim atë, dhe është shumë vështirë të kuptosh se çfarë materiali do të jetë i ri. Për ta bërë jetën më të lehtë për të gjithë, përfshirë edhe Trupi Gjykues. Ky është propozimi im që kisha për të bërë. për ta shtuar në qoftë se jeni dakord, në listën e urdhrave tuaja me gojë nesër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtja?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk kemi asgjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F502RED dhe F579*

Faleminderit.

Ju falënderoj palët dhe Mbrojtësin e Viktimave për pjesëmarrjen. Gjithashtu falënderoj përkthyesit, stenografin dhe teknikët, sigurinë për ndihmën e tyre.

Këtu përfundon sot seanca deri nesër në orën 14.00

--- Seanca mbyllet në orën 15.58